



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:254479

Datë: 04.11.2019

Numri i dokumentit: 00624820

P.nr.2656/15

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – **Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Ertan Sejfulla, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vahide Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurve I.K., A.K. dhe E.R. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.3202/2015, dt 30.07.2015, në mbështetje të nenit 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPPRK-së, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me dt.24.09.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET Akuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr. 3202/2015, dt 30.07.2015, dhe **PUSHOHET PROCEDURA PENALE** kundër të akuzuarve **I.K., A.K. dhe E.R.**, të akuzuar për shkak të veprës Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II.**Shpenzimet** e procedurës penale, bien në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës.

III. **Pala e dëmtuar** Drejtoria per Ekonomi dhe Zhvillim, Shërbimi i Pylltarisë Prishtinë, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civilo - juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur akuzën PP.II.nr.3202/2015, dt 30.07.2015. kundër të pandehurve I.K., A.K. dhe E.R., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të lëndës ndaj të pandehurve I.K., A.K. dhe E.R. dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të saj e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale, ngase në bazë të nenit 106 par. 1, pika 1.6, të KPRK-së, parashihet se parashkrimi shkaktohet në afat prej 2 vite nga kryerje e veprës penale të dënueshme deri në 1 (një) vit burgim. Në bazë të nenit 107, par. 8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, respektivisht ndalesa absolute mbi ndjekjen penale e që në rastin konkret parashkrimi për veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ka arritur me datë **26.02.2019.**

Për veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është paraparë që kryesi të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Andaj gjykata duke u bazuar ne nenin 358 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, e hudhi aktakuzën dhe e pushoj procedurën e mëtutjeshme penale ndaj të pandehurve dhe atë duke u bazuar në nenin 106 par.1 nënpar.6 e lidhur me nenin 107 par.8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Mbi shpenzimet e procedurës penale është vendosur në bazë të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së.

Udhëzimin e të dëmtuarës në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e mori duke u bazuar në nenin 463 të KPPRK-së.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.2656/15 datë 24.09.2019

Bashkëpunëtorja Profesionale
Vahide Krasniqi

G j y q t a r i
Ertan Sejfulla

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 (tre) ditësh prej ditës së pranimit përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.